



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	23.08.2022	viti god year	2
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojta Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	4933/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.689/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.689/2022 të datës 05.08.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi

kundër organit të punësimit- Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 4 dhe 5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjakshme Administrative, në seancën për këshillim dhe votim me datë 23.08.2022 mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.689/2019 e datës 05.08.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e caktuar në pozitën Zyrtare e buxhetit në Departamentin e buxhetit dhe Financave në Ministrinë e Shëndetësisë sipas akt emërimit të datës 10.02.2012 i nënshkruar me datën 12.03.2012, më datën 05.04.2022 ka bërë kërkesë me numër protokoll 05-1538, për Menaxherin e Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë për përmirësimin e përvojës së punës për shtatë (7) vite, prej vitit 1991-1998.

Ankuesja për shkak të heshtjes administrative nga Menaxheri i Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë lidhur me kërkesën e datës 05.04.2022, ka parashtruar ankesë me datën 30.05.2022 me numër protokoll 3142/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 06.06.2022, ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë. Me datën 07.06.2022 Ministria e Shëndetësisë ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 30.06.2022 ka nxjerrë Vendimin A.nr.488/2022 me numër protokolli 3831 me të cilin ka obliguar Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të bëj rishqyrtimin e kërkesës me numër protokolli 05-1538, të datës 05.04.2022 të parashtruar nga ankuesja

Me datën 07.07.2022 Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë është përgjigjur në kërkesën e ankueses të datës 05.04.2022 lidhur me njohjen e përvojës së punës për periudhën 1992 deri 1998.

Ankuesja e pakënaqur me përgjigjen e datës 07.07.2022 me numër protokolli 05.-1638/2 e Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, me datë 05.08.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3142/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesa e datës 05.08.2022 me numër protokolli 4544/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen e datës 07.07.2022 me numër protokolli 05.-1638/2 e Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë; Kërkesë për vendim e datës 18.07.2022 me numër protokolli 05-1538/3; Vendimi A.nr.488/2022 i datës 30.06.2022 me numër protokolli 3831/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokolli 3142/2022 të datës 30.05.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesa e datës 05.04.2022 me numër 05-1538 e parashtruar për Menaxherin e Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë; Vendimi për ekzekutimin e Aktvendimit i datës 21.08.1998; Vendim i datës 21.08.1998; Vërtetim i kopjes nga origjinali; Aktvendimi i Gjykatës Komunale në Mitrovicën e Kosovës i datës 06.02.1996; E-mail zyrtar i datës 30.05.2022; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 07.06.2022 me numër protokolli 3306/2022 bashkë me shkresat e lëndës; Vendim Nr.DBNJ-63/15 i datës 05.08.2015 ; Akt emërimi i datës 10.02.2012; Kopja e librezës së punës dhe Formulari për aplikim në Ministrinë e Shëndetësisë i datës 24.01.2003.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ekziston baza ligjore që të refuzohet *ankesa e ankueses, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se pas Vendimit A.nr.488/2022 i datës 30.06.2022 me numër protokolli 3831/2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, me datën 07.07.2022 i është përgjigjur në kërkesën e datës 05.04.2022 të ankueses.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës ka konstatuar se me vendimin e datës 05.08.2015 të nxjerrë nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në ministrinë e Shëndetësisë, ankueses në bazë të dëshmive të ofruara lidhur me përvojën e punës i pranohen 22 vite e 1 muaj përvojë pune. Bazuar në këshillën juridike të vendimit ankuesja në rast se është e pakënaqur ka pasur të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Administratës Publike.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se ankuesja përkundër që ka pas të drejtë ligjore në ankesë sipas këshillës juridike të vendimit Nr.DBNJ-63/15 të datës 05.08.2015 një të drejtë të tillë nuk e ka shfrytëzuar ndërsa pa i shfrytëzuar mjetet juridike konformë vendimit të potencuar si më lartë i është drejtuar me ankesë Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e që është jashtë afatit ligjor prej tridhjetë (30) ditësh të përcaktuar me dispozitat e nenit 127, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative i cili përcakton se: *"1.Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ"*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ,bazuar në provat e lëndës si dhe gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, konstaton se me qëllim të përcaktimit të rregullave dhe procedurave të dëshmimit të përvojës së punës respektivisht me qëllim të pagesës së shtesës mbi përvojën e punës, Qeveria e Republikës së Kosovës me datë 15.05.2015 ka nxjerr Vendim me nr.06/29 me të cilin në pikën 2 ka përcaktuar se *"Njohja e përvojës së punës pas qershorit 1999 dëshmohet përmes njërit nga këto dëshmi:2.5. Dëshmisë mbi përvojën e punës të lëshuar nga Organizatat Qendrore dhe Joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare të shoqëruara me dëshminë për kryerjen e obligimeve mbi të ardhurat personale ose dëshminë mbi pagesën e kontributeve pensionale pranë organit kompetent"*, në këtë kuptim , Kolegji i këshillit vlerëson se ankuesja për njohjen e përvojës së punës bazuar në provat shtesë nuk ka arrit të argumentojë me dëshmi relevante se konformë Vendimit me nr.06/29 datë 15.05.2015 i takon një e drejtë e tillë sipas objektit të kësaj ankese dhe se nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim ligjorë nga momenti i marrjes së vendimit të apostrofuuar më lartë me qëllim të realizimit të ndonjë kërkesë shtesë sa i përket përvojës së punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave duke u bazuar në shkresat e lëndës konstaton se ankuesja prej vitit 2015 kur është nxjerrë vendimi për njohje të përvojës së punës sipas vendimit nr.06/29 datë 15.05.2015 nuk ka dërgue asnjë dëshmi shtesë te institucioni përkatës lidhur me ndonjë përvojë të punës shtesë deri më datën 05.04.2022 kur ka dërgue këto dokumente,Librezën e punës të ankueses,Formularin për aplikim të datës 24.01.2003,vendimin për ekzekutimin e aktvendimit, datë 21/08/1998 dhe aktvendimin e gjykatës komunale në Mitrovicë të datës 08/02/1998, ndërsa të njëjtat dëshmi Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë i ka përcjell tek Këshilli, ndërsa kolegji i këshillit duke analizuar me kujdes këto prova ka konstatuar se edhe në formularin e punësimit të vitit 2003 dhe në librezë të punës të ofruar nga vetë ankuesja nuk figuron përvoja e punës gjatë kësaj periudhe 1991 deri më 1998 e pretenduar nga ankuesja sipas shkresave të lëndës dhe objektit të kësaj ankese.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave bazuar në shkresat e lëndës dhe duke pasur parasysh gjithnjë vendimin Nr.DBNJ-63/15 të datës 05.08.2015 kur ka fillue të rrjedhë afati ligjor i realizimit të një të drejte të pretenduar të ankueses, dhe me qenë se nga ajo kohë nuk

kemi pasur asnjë veprim për realizim të kësaj kërkesë tashmë pretendimi mbi pagesën retroaktive shtesë të përvojës së punës është i pabazuar nga se sipas legjislacionit përkatës respektivisht Ligjin e Punës tashmë kjo kërkesë e natyrës monetare është e vjetruar/parashkruar pasi specifikisht në nenin 87 të Ligjit të Punës Nr. 03/ L-212 parashihet;” *Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës*”, dhe nëse marrim parasysh faktin se nga viti 2015 kur sipas vendimit Nr.DBNJ-63/15 të datës 05.08.2015 ankuesja ka pas mundësi të shfrytëzoj mjetet ligjore të realizimit të kërkesës ndërsa nuk është ndërmarrë asnjë veprim sa i përket këtij qëllimi dhe mbi këtë bazë pretendimi i ankueses për pagesë retroaktive shtesë të përvojës së punës është i pabazuar.

Pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A nr.689/2022, datë 23/08/2022

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Zyrtarë i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

